

nr. 116 Pres.
Dl 18.08.2015
Guy



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SËPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHETËTORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

URDHËR

Nr. 5948 / Datë 17.9.2015

PËR

ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SH.A "TRAJTIMI I STUDENTËVE" GJIROKASTËR.

Drejtuar: SH.A "TRAJTIMI I STUDENTËVE" GJIROKASTËR ✓

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe Urdhrit të MZHETTS Nr. 4075/1, datë 8.6.2015, me cilësinë e aksionarit të vetëm të Sh.a "Trajtimi i Studentëve" Gjirokastër,

URDHËROJ:

1. Kapitali themeltar të zvogëlohet për vlerën 72 756 000 lekë, i barabartë me 72 756 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila, që i përket sistemit të humbjes së ushtrimit dhe humbjes së mbartur.
2. Kapitali Themeltar i shoqërisë bëhet 727 244 000 lekë, i barabartë me 727 244 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë.
4. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ngarkohet Drejtoria e shoqërisë "Trajtimi i Studentëve" Gjirokastër për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ARBEN AHMETAJ

